



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 4 nëntor 2016
Nr. ref.:RK994/16

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI24/16

Parashtrues

Avdi Haziri

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 191/2015, të 1 shtatorit 2015

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Avdi Haziri (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës) nga Gjilani, i përfaqësuar nga Basri Jupolli, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 191/2015, të 1 shtatorit 2015, në lidhje me Vendimin e Gjykatës së Apelit, Ca. nr. 4315/2012, të 6 shkurtit 2015, Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Gjilan, C. nr. 681/11, të 4 shtatorit 2012, Aktvendimin e Gjykatës së Qarkut në Gjilan, AC. nr. 148/11, të 21 shtatorit 2011, dhe Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Gjilan, C. nr. 232/2004, të 18 marsit 2011.
3. Vendimi i Gjykatës Supreme i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 16 tetor 2015.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 191/2015, të 1 shtatorit 2015, me pretendimin se parashtruesit të kërkesës i është cenuar e drejta në pronë, siç garantohet me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).
5. Parashtruesi i kërkesës po ashtu në substancë ngre pretendime për shkeljen e të drejtës në gjykim të drejtë dhe të paanshëm, por pa iu referuar ndonjë dispozite kushtetuese në veçanti.

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

7. Më 4 shkurt 2016, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).
8. Më 14 mars 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Gresa Caka-Nimani gjyqtare raportuese dhe Kolegin shqyrtaues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Bekim Sejdiu dhe Selvete Gërxhaliu-Krasniqi.
9. Më 27 prill 2016, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe nga një kopje e kërkesës iu dërgua Gjykatës Supreme dhe Gjykatës së Apelit.
10. Më 29 prill 2016, Gjykata kërkoi nga parashtruesi i kërkesës dhe nga Gjykata Themelore në Gjilan që të dorëzojnë dëshmi (fletë-kthesë), që tregon ditën e

pranimit të Aktvendimit të kontestuar të Gjykatës Supreme nga parashtruesi i kërkesës.

11. Më 12 maj 2016, Gjykata ka pranuar dëshminë (fletë-kthesën), që dëshmon se parashtruesi i kërkesës ka pranuar vendimin e Gjykatës Supreme, më 16 tetor 2015.
12. Më 15 shtator 2016, Kolegji shqyrtyes shqyrtoi raportin e gjyqtarit rapportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përbledhja e fakteve

13. Nga dokumentet e përfshira në kërkesë rezulton se vëllezërit e parashtruesit të kërkesës në vitin 1984 i kishin shitur një paluajtshmëri palës së tretë A. J. Pas një periudhe të gjatë kohore, të paktën pas 20 (njëzetë) vitesh, parashtruesi i kërkesës kishte kontestuar titullin pronësor të A. J. ndaj paluajtshmërisë në fjale.
14. Më 25 prill 2004, A. J. kishte paraqitur padi - kërkesëpadi në Gjykatën Komunale në Gjilan për vërtetim të titullit pronësor ndaj paluajtshmërisë që kontestohej nga parashtruesi i kërkesës. Vlera e objektit të kontestit në padinë e A. J. ishte përcaktuar në shumën prej 250 euro. Kjo vlerë ishte pranuar nga gjykatat dhe parashtruesi i kërkesës nuk e kishte kontestuar këtë shumë në asnjëren prej instancave të gjyqësorit të rregullt.
15. Më 18 mars 2011, Gjykata Komunale në Gjilan, me Aktgjykimin C. nr. 232/2004, aprovoi kërkesëpadinë e A. J. si të bazuar. Gjykata Komunale, ndër të tjera, arsyetoi se në vitin 1984, vëllezërit e parashtruesit i kishin shitur paluajtshmërinë A.J-së; se paluajtshmëria e kontestuar ishte mbajtur në mirëbesim nga A. J. për 20 (njëzetë) vite pa u penguar nga askush, dhe rrjedhimisht, në pajtim me ligjin e zbatueshëm në Kosovë A. J. kishte fituar titullin pronësor ndaj paluajtshmërisë së kontestuar.
16. Më 13 prill 2011, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Qarkut në Gjilan, duke pretenduar shkelje të dispozitive procedurale, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.
17. Më 21 shtator 2011, Gjykata e Qarkut në Gjilan, me Aktvendimin AC. nr. 148/11, e pranoi ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe prishi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale, duke e kthyer lëndën në rivendosje.
18. Më 4 shtator 2012, Gjykata Komunale me Aktgjykimin C. nr. 681/11, sërisht aprovoi kërkesëpadinë e A. J. dhe vërtetoi se A. J. është pronar i paluajtshmërisë së kontestuar në bazë të shitblerjes dhe parashkrimit fitues.
19. Më 9 tetor 2012, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Qarkut për shkak të shkeljeve të ligjit procedural, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.
20. Më 6 shkurt 2015, Gjykata e Apelit me Vendimin CA. nr. 4315/2012, refuzoi të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Aktgjykimin e

Gjykatës Komunale. Gjykata e Apelit përvetësoi arsyetimin e Gjykatës Komunale, duke shtuar se konstatimet e saj janë të drejta.

21. Më 7 prill 2015, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme për shkak të shkeljes thelbësore të ligjit procedural dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.
22. Më 1 shtator 2015, Gjykata Supreme me Aktvendimin Rev. nr. 191/2015, hodhi poshtë, si të palejuar revizionin e parashtruesit të kërkesës të paraqitur ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit. Gjykata Supreme arsyetoi se kërkesa për revizion e paraqitur nga parashtruesi ishte e palejuar, sepse vlera e objektit të kontestit nuk e kalon shumën prej 3,000 euro siç përcaktohet me nenin 211.3 të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Gjykata Supreme më tej shtoi se në kohën kur paditësi A. J. kishte paraqitur padinë në Gjykatën Komunale në Gjilan, kishte cekur vlerën e kontestit në shumë prej 250 euro.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

23. Parashtruesi i kërkesës pretendon se në rastin e tij është shkelur e drejta në pronë e garantuar me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës.
24. Për sa i përket procedurave të zhvilluara në gjykatat e rregullta, parashtruesi i kërkesës pretendon: (i) se shitblerja e pronës së kontestuar është kryer nga jo pronari, sepse parashtruesi i kërkesës dhe vëllezërit e tij nuk e kishin përfunduar ndarjen e trashëgimisë; (ii) se asnjeherë nuk është vërtetuar pagesa e shitblerjes; dhe (iii) se është jo logjike që vlerën e këtij kontesti pronësor, gjykatat e rregullta e kanë përligjur në shumën prej 250 euro.
25. Në këtë drejtim, sa i përket pretendimit të parë, parashtruesi i kërkesës thekson: "... në të gjitha vendimet gjyqësore gabimi i vendosjes konsiston në mos marrjen parasysh të provës vendimtare se shitblerja ka ndodhur me jo pronarin, sepse jo pronari kurrë nuk është bërë pronar, sepse as me trashëgimi as me ndonjë mënyrë tjetër...".
26. Sa i përket pretendimit të dytë, parashtruesi i kërkesës thekson: "... Gjykatat nuk kanë vërtetuar drejt dhe objektivisht as gjendjen faktike që lidhet me çmimin e shitblerjes ngase në shkresat e lëndës nuk ka prova materiale për pagesat e bëra dhe këto pagesa kanë mbetur të pasqaruara dhe kontestuese tek trashëgimtarët".
27. Ndërsa sa i përket pretendimit të tretë, parashtruesi i kërkesës thekson: "... Mbrojtja gjithashtu thekson se të gjitha gjykatat e kanë përligjur vlerën e kontestit të caktuar në tekstin e padisë fillestare në shumën 250 €, ndërsa kontesti është zhvilluar për një vlerë prej 200,000.00 DM".

Pranueshmëria e kërkesës

28. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

29. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113 të Kushtetutës, që përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar”.

(...)

“7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

30. Gjykata po ashtu i referohet nenit 48 të Ligjit, që parasheh:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

31. Gjykata, më tej, merr parasysh rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (d) të Rregullores së punës, që specifikon:

“(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

[...]

(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi te pabazuar, nëse bindet se:

(d) parashtruesi nuk dëshmon ne mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

32. Gjykata vëren se çështja kryesore në këtë rast është titulli pronësor dhe vërtetimi i pronësisë ndaj pronës së kontestuar, me ç'rast nga vendimet e gjykatave të rregullta rezulton se A. J. ka fituar titullin e pronësisë në bazë të shitblerjes dhe mbajtjes me mirëbesim dhe shfrytëzim të papenguar të pronës së kontestuar për më tepër se 20 (njëzetë) vite në përputhje me nenin 28 të Ligjit të Marrëdhënieve Themelore Pronësore Juridike, siç kanë arsyetuar në mënyrë të detajuar gjykatat e rregullta.

33. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës është i pakënaqur me vendimet e gjykatave të rregullta për sa i përket: (i) mosmarrjes parasysh të provës vendimtare se shitblerja ka ndodhur me jo pronarin; (ii) nuk është vërtetuar drejt dhe objektivisht gjendja faktike përkitazi me çmimin e shitblerjes; dhe (iii) se të gjitha gjykatat e kanë përligjur vlerën e kontestit të caktuar në tekstin e padisë fillestare në shumën 250 €. Si rezultat, parashtruesi pretendon se atij i është cenuar e drejta në pronë siç garantohet me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës.

34. Për sa i përket pretendimit të parë dhe të dytë të parashtruesit të kérkesës, përkatësisht, kundërligjshmërisë e shitjes së paluajtshmërisë së kontestuar si dhe çmimit të shitjes, Gjykata vëren se gjykatat e rregullta kanë dhënë arsyetim të mjaftueshmë, duke shpjeguar bazat juridike dhe faktike të fitimit të titullit të pronësisë nga A. J, duke paguar çmimin blerës dhe duke ushtruar mbi 20 (njëzetë) vite posdim me mirëbesim pa u penguar ose kontestuar nga askush, siç parashihet në Ligjin e Marrëdhënieve Themelore Pronësore Juridike, të cilit në mënyrë të vazhdueshme i janë referuar gjykatat e rregullta.

35. Gjykata e Apelit në arsyetimin e saj, ndër të tjera, theksoi:

“Duke pasur parasysh faktin e pakontestueshëm se paditësi më se 20 vjet e shfrytëzon patundshmërinë lëndore në posdim të së cilës ka hyre në bazë të kontratës gojore të shitblerjes dhe pagesës së çmimit të shitblerjes, dhe se me këtë rast nuk është penguar nga të paditurit, kjo gjykatë gjeti se paditësi është mbajtjes i ndërgjegjshëm i patundshmërisë kontestuese. Ky posdim është i ligjshëm, sepse është bazuar në kontratën gojore, me qenë se asnjeri nga të paditurit në gjykatën e shkallës së parë nuk ka kundërshtuar se ishte fituar me dhunë, me mashtrim ose me keqpërdorin te besimit”.

36. Për sa i përket pretendimit të tretë të parashtruesit të kérkesës, përkatësisht vlerës së kontestit, Gjykata vëren se parashtruesi nuk e kishte kundërshtuar vlerën e kontestit në asnjerën prej instancave të gjyqësorit të rregullt. Madje në paditë dhe përgjigjet në padi edhe vetë kishte cekur shumën që tanë e konteston. Nuk ka asgjë në kérkesë që tregon se kjo çështje është ngritur nga parashtruesi i kérkesës gjatë zhvillimit të procedurave në gjykatat e rregullta, madje as në kérkesën për revizion të drejtuar Gjykatës Supreme, e cila, e hodhi poshtë si të palejuar revizionin në bazë të vlerës së kontestit, siç është përcaktuar me Ligjin për Procedurën Kontestimore.

37. Pjesa relevante e Aktvendimit të Gjykatës Supreme përcakton:

“... në kohën kur paditësi e ka paraqitur padinë në Gjykatën Komunale në Gjilan, më 25.5.2004, duke cekur vlerën e kontestit në shumë prej 250 €. Duke pasur parasysh që aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët janë marrë në kohën kur ka hyrë fuqi Ligji mbi Procedurën Kontestimore nr. 03/L-006 datë 30 qershor 2008 e shpallur në Gazeten Zyrtare nr. 38/2008, ndërsa ka hyrë fuqi më 5.10.2008, edhe me dispozitën e nenit 211.3 të LPK, revizioni nuk lejohet në kontestet pasurore-juridike në të cilat kérkesëpadia nuk ka të bëj me kérkesat në para, me dorëzimin e sendit apo me përbushjen e ndonjë premimi tjetër, po që se vlera e objektit të kontestit nuk e kalon shumën prej 3.000 euro. Për faktin se vlera e objektit të kontestit e treguar në padinë e paditësit është 250 € dhe nuk e kalon shumën e paraparë me dispozitën e nenit 211.3 të LPK, revizioni në këtë çështje juridike nuk është i lejuar dhe si i tillë duhet të hidhet poshtë”.

38. Në fakt, ky pretendim është ngritur për herë të parë në Gjykatën Kushtetuese. Gjykata Kushtetuese, në pajtim me parimin e subsidiaritetit, nuk mund ta vlerësojë këtë çështje pa qenë paraprakisht e ngritur dhe vlerësuar në procedurë të rregullt.

39. Parimi i subsidiaritetit kérkon që parashtruesi të shterojë të gjitha mundësítë procedurale në procedurë të rregullt, në mënyrë që të parandalohet shkelja e Kushtetutës apo, nëse ka shkelje, të korrigjohet shkelja e tillë Kushtetuese. Pérndryshe, parashtruesi i kérkesës éshtë përgjegjës kur rasti i tij shpallet i papranueshém nga Gjykata Kushtetuese, nëse dështon të shfrytëzojë procedurat e rregullta, apo dështon të raportoj shkeljet e pretenduara në procedurë të rregullt. (*Shih, Aktvendimi në rastin KI139/12, Besnik Asllani, Vlerësim i Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, PKL. nr. 111/2012, i 30 nëntorit 2012, paragrafi 45; Aktvendimi në rastin nr. KI07/09, Demë KURBOGAJ dhe Besnik KURBOGAJ, Vlerësim i Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pkl. nr. 61/07, të 24 nëntorit 2008, paragrafi 18; Aktvendim në rastin nr. KI89/15, Fatmir Koci, Vlerësim i Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, PAKR. nr.473/2014, i 21 nëntorit 2014, paragrafi 35; dhe shih mutatis mutandis, Selmouni kundër Francës, [DHM] § 74; Kudla kundër Polonisë [DHM] § 152; And rashik dhe të tjerët kundër Slovacisë [aktvendim]).*
40. Për më tepër, Gjykata thekson se nuk éshtë detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të janë bërë nga gjykata e rregullta gjatë vlerësimit të provave apo zbatimit të ligjit (ligjshmëria), përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura nga Kushtetuta (kushtetutshmëria).
41. Gjykata Kushtetuese rithekson se nuk éshtë gjykatë e gjetjes së fakteve dhe se vërtetimi i drejtë dhe i plotë i gjendjes faktike éshtë juridiksion i plotë i gjykatave të rregullta, ndërsa roli i Gjykatës Kushtetuese éshtë vetëm ta sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat që garantohen me Kushtetutë dhe instrumente të tjera ligjore. Rrjedhimisht, Gjykata Kushtetuese nuk mund të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt (shih rastin *Akdivar kundër Turqisë*, Nr. 2189/93, GJEDNJ, Aktgjykimi i 16 shtatorit 1996, para. 65 dhe, po ashtu, shih rastin KI86/11, parashtrues i kérkesës *Milaim Berisha*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 5 prillit 2012).
42. Kérkesa e parashtruesit nuk arrin të dëshmojë që gjykatat e rregullta kanë vepruar në mënyrë arbitrale apo të padrejtë. Nuk éshtë detyrë e Gjykatës Kushtetuese ta zé vendësojë vlerësimin e vet të fakteve me atë të gjykatave të rregullta dhe, si rregull i përgjithshém, éshtë detyrë e këtyre gjykatave që t'i vlerësojnë provat e vëna në dispozicion të tyre. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse procedurat në gjykatat e rregullta në përgjithësi janë mbajtur në mënyrë të tillë, saqë parashtruesi i kérkesës të ketë pasur gjykim të drejtë (Shih rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Nr. 13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejta të Njeriut, i 10 korrikut 1991).
43. Fakti që parashtruesi nuk pajtohet me rezultatin e rastit nuk mund të ngrejë kérkesë të argumentueshme për shkelje të nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës (shih rastin *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, Nr. 5503/02, GJEDNJ, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005).
44. Në këto rrethana, Gjykata konsideron se parashtruesi i kérkesës nuk e ka mbështetur me prova e as nuk e ka arsyetuar mjaftueshém pretendimin e tij për shkelje të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë,

specifikesht, për shkelje të nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës, sepse faktet e paraqitura nga ai në asnjë mënyrë nuk tregojnë që gjykatat e rregullta i kanë mohuar atij të drejtat e garantuara me Kushtetutë.

45. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohet e papranueshme siç përcaktohet me nenin 113.7 të Kushtetutës, parashihet me nenin 48 të Ligjit dhe më tej specifikohet me kriteret e pranueshmërisë, rregullat 36 (1) (d) dhe (2) (d) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (d) të Rregullores së punës, më 15 shtator 2016, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Gresa Caka-Nimani
Gresa Caka-Nimani

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi
Arta Rama-Hajrizi